

Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për Tremujorin e Tretë 2017

Tetor 2017¹

Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2017 tregojnë se **standardet** e kredisë janë shtrënguar për bizneset ndërsa janë lehtësuar për individët. Sipas madhësisë së biznesit vihet re se standardet e kreditimit për *ndërmarrjet e vogla dhe të mesme* kanë mbetur të lehtësuara njësoj si një tremujor më parë, ndërsa në *segmentin e ndërmarrjeve të mëdha* standardet janë shtrënguar. Për individët, standardet e kredisë rezultuan të lehtësuara, si në segmentin e kredisë për blerje banesa, ashtu edhe për kredinë konsumatore.

Faktori kryesor që ndikoi në kahun lehtësues të standardeve të bankave për kredinë dhënë bizneseve është *konkurrenca në tregun bankar*. Në kahun shtrëngues kanë ndikuar kryesisht *huatë me probleme, situata e perceptuar makroekonomike*, si edhe *problemet specifike të sektorit*. Përsa i përket individëve, faktorët që kanë ndikuar në lehtësimin e standardeve rezultuan *mjaftueshmëria e kapitalit, niveli i likuiditetit, si edhe konkurrenca në sistemin bankar*. Në kahun shtrëngues për këtë segment kanë ndikuar *gjendja financiare e individëve, zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme*, si edhe *huatë me probleme*.

Shtrëngimi i kushteve të kredisë të bizneseve u zbatua kryesisht nëpërmjet *zvogëlimit të madhësisë së kredisë dhe rritjes së kërkesave për kolateral*, ndërsa lehtësimi i tyre u shpreh nëpërmjet *zvogëlimit të komisioneve dhe marzhit mesatar*. Bankat shprehen se lehtësimi i kushteve të kredisë për individë u zbatua kryesisht nëpërmjet *zbutjes së kërkesave për kolateral, ngushtimit të marzhit mesatar për kreditë dhe rritjes së raportit të këstit ndaj të ardhurave*.

Kërkesa për kredi në tremujorin e tretë të vitit 2017 u raportua e rritur si për bizneset, ashtu edhe për individët në të gjitha segmentet.


Bankat **presin** lehtësim të standardeve të kreditimit për bizneset, ndërsa standardet e kredisë për individët priten të mbeten të pandryshuara në tremujorin e katërt 2017. Kërkesa për kredi parashikohet në rritje si për bizneset, ashtu edhe për individët.

¹Vrojtimi i realizuar në fund të muajit shtator mbulon zhvillimet në aktivitetin kreditues të tremujorit të tretë të vitit 2017, si dhe pritjet e bankave për aktivitetin kreditues për tremujorin e katërt.

Kredia për bizneset

Standardet e kredisë për bizneset janë shtrënguar në tremujorin e tretë të vitit 2017. Ndryshe nga sa pritej nga tremujori i kaluar, kushtet e kreditimit për *ndërmarrjet e mëdha* rezultojnë të shtrënguara. Ndërkohë, në segmentin e *ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme* standardet kanë mbetur njësoj të lehtësuara si një tremujor më parë. Në tremujorin e fundit të vitit 2017, bankat presin që standardet e kreditimit të lehtësohen si në segmentin e *ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme*, ashtu edhe për *ndërmarrjet e mëdha*. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, standardet mbeten në kahun lehtësues për kreditë për *kapital qarkullues*, ndërsa për *investime* ato janë shtrënguar. Në tremujorin e ardhshëm pritet që standardet për të dy këto kategori të lehtësohen.

Grafik 1: Standardet e kredisë për bizneset në total, sipas madhësisë dhe qëllimit të përdorimit të kredisë (balanca neto²)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 1. Balanca neto është përqindja e bankave që kanë ndryshuar standardet; balanca pozitive tregon lehtësim të standardeve, ndërsa balanca negative tregon shtrëngim të standardeve.

Faktorët që ndikuan në shtrëngimin e standardeve të kredisë për bizneset ishin *problemet specifike të sektorit* ku vepron biznesi, *kreditë me probleme*, *perceptimi i bankave mbi situatën makroekonomike*, si edhe *mjaftueshmëria e kapitalit*², të cilët vijnë në ndikim në kahun shtrëngues (Grafiku 2). Konkurrenca në tregun bankar rezultoi si faktori me ndikim pozitiv në lehtësimin e standardeve të kredisë për bizneset në tremujorin e tretë.

Grafik 2: Ndikimi i faktorëve në standardet e kredisë për bizneset (balanca neto²)




² Vetëm një bankë pjesëmarrëse në vërtetimin e ka cilësuar këtë faktor me ndikim në kahun shtrëngues.

Burimi: Banka e Shqipërisë. Shënim 2. Balanca pozitive tregon që faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve të kredithënies; balanca negative tregon që faktori ka ndikuar në shtrëngimin e standardeve të kredithënies.

Standardet e kreditimit janë shtrënguar nëpërmjet rritjes së kërkesave për kolateral, uljes së madhësisë së kredisë, si edhe marzheve më të larta për kreditë me rrezik³. Nga ana tjetër, lehtësimi i standardeve të kreditimit të bizneseve në tremujorin e tretë të vitit 2017 u realizua nëpërmjet uljes së komisioneve dhe reduktimit të marzhit mesatar.

Grafik 3: Ndryshimi i kushteve për miratimin e kredive të bizneseve (balanca neto³)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 3. Balanca pozitive tregon lehtësim të kushteve, ndërsa balanca negative tregon shtrëngim të kushteve.

Kërkesa për kredi është rritur në tremujorin e tretë të vitit 2017 e mbështetur si nga segmenti i ndërmarrjeve të mëdha, ashtu edhe nga ato të vogla dhe të mesme. Sipas qëllimit të përdorimit, këtë tremujor bizneset kanë shfaqur kërkesë më të lartë si për kredinë për kapital qarkullues, ashtu edhe për kredinë për investime (Grafiku 4). Në tremujorin e katërt të vitit, bankat presin rritje të kërkesës, të mbështetur nga të dy segmentet e biznesit.

Grafik 4: Kërkesa për kredi e bizneseve sipas madhësisë së biznesit dhe qëllimit të përdorimit të kredisë (balanca neto⁴)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 4. Balanca pozitive tregon rritje të kërkesës për kredi, ndërsa balanca negative tregon rënie.

³ Marzhi për kreditë me rrezik është vlerësuar si faktor me ndikim shtrëngues në kushtet e kreditimit të bizneseve prej një banke të vetme.

Faktorët që kanë ndikuar kërkesën. Bankat raportojnë se kërkesa për kredi nga ana e bizneseve është mbështetur nga nevoja për financimin e kapitalit qarkullues dhe investimeve, si dhe nga kushtet e favorshme të kreditimit. Kërkesa më e ulët për kredi është perceptuar nga bankat si pasojë e përdorimit të burimeve alternative të financimit⁴ dhe ndikimit të situatës makroekonomike.

Grafik 5: Ndikimi i faktorëve të kërkesës për kredi të bizneseve (balanca neto⁵)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim 5. Balanca pozitive tregon që faktori ka ndikuar në rritjen e kërkesës, ndërsa balanca negative tregon që faktori ka ndikuar në uljen e kërkesës për kredi.

Kredia për individë

Standardet e kredisë. Mbështetur në rezultatet e pyetësorit, standardet e kredisë për individët rezultuan të lehtësuara në tremujorin e tretë të vitit 2017. Ndryshe nga tremujori paraardhës, standardet u raportuan në kahun lehtësues për segmentin e kredisë për blerje banese. Ndërkohë, standardet për kredinë për konsum kanë pasur gjithashtu kahun lehtësues, por në një masë më të ulët se në tremujorin paraardhës. Për tremujorin e katërt të vitit, bankat presin që standardet e kredisë për individë të mbeten të pandryshuara në të dy segmentet.

Grafik 6: Standardet e kredisë për individët në total dhe sipas qëllimit të përdorimit (balanca neto)




Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

⁴ Burimet alternative të financimit përfshijnë: (i) fondet e veta të klientëve; (ii) huamarrjen nga institucionet jobanka; dhe (iii) huamarrjen në një bankë tjetër.

Faktorët që kanë ndikuar standardet e kredisë për individë në kahun lehtësues ishin niveli i *likuiditetit, mjaftueshmëria e kapitalit* të bankave dhe rritja e *konkurrencës në sektorin bankar*. Gjendja financiare e individëve, situata në *tregun e pasurive të paluajtshme*, si edhe *kreditë me probleme* kanë vepruar në kahun shtrëngues edhe për këtë tremujor.


Grafik 7: Ndikimi i faktorëve në standardet e kredisë për individët (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Kushtet për miratimin e kredisë. Si instrument kryesor për lehtësimin e kushteve të kreditimit për individë, bankat kanë përdorur ngushtimin e *marzhit mesatar*, si edhe zbutjen e *kërkesave për kolateral*. Gjithashtu, në kahun lehtësues, por në një masë më të vogël, kanë vepruar edhe kushtet e tjera si *rritja e raportit të këstit ndaj të ardhurave*, *rritja e madhësisë së kredisë*, zvogëlimi i *komisioneve* dhe i *kërkesave për kolateral*.


Grafik 8: Kushtet e aplikuara për miratimin e kredisë për individët (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Kërkesa për kredi. Bankat raportojnë rritje të kërkesës së individëve për kredi në tremujorin e tretë të vitit 2017, në përputhje me pritjet e tremujorit të kaluar. Zgjerimi i kërkesës për kredi nga individët është mbështetur kryesisht nga kërkesa për *kredi hipotekare*, ndërsa kërkesa për *kredi konsumatore* shfaqet e pandryshuar. Ekspertët e bankave presin që kërkesa në total e individëve të vijojë me rritje edhe në tremujorin e ardhshëm.


Grafik 9: Kërkesa për kredi nga individët totale dhe sipas qëllimit të përdorimit (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Faktorët që kanë ndikuar kërkesën. Rritja e kërkesës së individëve për kredi në tremujorin e tretë të vitit 2017 është nxitur kryesisht nga rritja e nevojës për *financimin e konsumit* dhe për *financimin e blerjes së banesave*, si edhe nga *kushtet e kreditimit*. Ndërkohë, ekspertët e bankave raportojnë se zhvillimet e tregut të pasurive të paluajtshme kanë ndikuar negativisht kërkesën për kredi të individëve.


Grafik 10: Ndikimi i faktorëve në kërkesën për kredi të individëve (balanca neto)



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Pritjet për aktivitetin kreditues sipas monedhës. Në tremujorin e katërt të vitit 2017, bankat presin rritje të kreditimit në lekë dhe rënie për kreditimin në valutë. Për tremujorin e ardhshëm, pothuajse të gjitha bankat presin rënie të normave të interesit të kredisë si në lekë ashtu edhe në valutë.

Grafik 11: Pritjet për aktivitetin kreditues (majtas); pritjet për normat e interesit (djathtas); (balanca neto)⁶



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Shënim 6: Balanca pozitive tregon rritje të aktivitetit kreditues ose rritje të normës së interesit, ndërsa balanca negative tregon ulje të aktivitetit kreditues ose ulje të normës së interesit.

Aneksi 1. Kredia për biznese

Rezultatet e pyetësorit analizohen duke llogaritur balancën neto si diferencën e përgjigjeve të peshuara të bankave, që kanë raportuar lehtësim/ritje të standardeve/kërkesës dhe atyre, që kanë raportuar shtrëngim/ulje të standardeve/kërkesës. Në procesin e agregimit të rezultateve, përgjigja e secilës bankë peshohet si në bazë të përgjigjes së saj, ashtu edhe në bazë të peshës së madhësisë së bankës. Për shembull, bankave që janë përgjigjur se standardet janë “shtrënguar shumë” u është dhënë dyfishi i peshës, krahasuar me përgjigjet “shtrënguar pak”. Peshat e madhësisë ndërtohen duke u bazuar në pjesën që secila bankë zë në tregun e kredisë dhe rishikohen një herë në vit. Balancat neto janë shkallëzuar në mënyrë që të marrin vlera brenda intervalit +/- 100.

BIZNESE	T2'16	T3'16	T4'16	T1'17	T2'17	T3'17
Si kanë ndryshuar standardet e miratimit të kredisë?						
- Tremujorin e kaluar	-4.4%	-13.4%	-12.1%	-11.9%	1.2%	-4.4%
- Tremujorin e ardhshëm	13.1%	-1.0%	-10.0%	-9.1%	1.2%	2.6%
Faktorët që kanë ndikuar standardet e miratimit të kredisë:						
-Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës	12.5%	-7.1%	-14.7%	-15.0%	-15.0%	-15.0%
-Vendimet e Bankës së Shqipërisë	2.4%	9.6%	7.0%	1.4%	1.4%	1.4%
-Konkurrenca në sistemin bankar	22.2%	16.9%	16.9%	21.7%	21.7%	13.3%
-Niveli aktual ose i pritshëm i likuiditetit	6.4%	4.3%	7.0%	2.2%	2.2%	-0.5%
-Probleme specifike të sektorit ku vepron biznesi	-31.3%	-34.7%	-36.1%	-36.2%	-24.6%	-20.9%
-Situata aktuale ose e pritshme makroekonomike	-28.3%	-20.6%	-20.6%	-19.2%	-13.4%	-13.4%
-Kreditë me probleme	-25.5%	-26.3%	-26.3%	-24.8%	-19.0%	-24.6%
Si kanë ndryshuar kushtet e miratimit të kredisë?						
-Marzhi mesatar	18.6%	9.0%	6.2%	5.3%	5.3%	3.9%
-Marzhi për kreditë me rrezik	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	-5.7%
-Komisionet	11.7%	6.6%	6.6%	1.2%	7.0%	7.0%
-Madhësia e kredisë	3.6%	1.3%	-1.4%	-1.4%	-1.4%	-20.2%
-Kërkesa për kolateral/në raport me madhësinë e kredisë	-12.2%	-12.1%	-9.4%	-22.0%	-8.8%	-10.2%
-Maturiteti maksimal i kredisë	-1.0%	1.0%	1.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Si ka ndryshuar kërkesa e bizneseve për kredi?						
-SME tremujorin e kaluar	12.7%	-9.0%	2.6%	12.0%	13.4%	3.8%
-SME tremujorin e ardhshëm	21.9%	28.4%	22.3%	3.9%	7.0%	17.0%
-Korporata tremujorin e kaluar	-4.2%	5.9%	0.3%	4.3%	-1.2%	9.4%
-Korporata tremujorin e ardhshëm	-1.8%	31.4%	8.2%	-9.1%	14.1%	17.0%
Faktorët që kanë ndikuar ndryshimin e kërkesës për kredi:						
-Nevoja për financimin e inventarëve	35.8%	30.3%	31.7%	28.6%	0.0%	33.7%
-Nevoja për financimin e investimeve fikse	19.2%	38.3%	33.3%	33.5%	39.3%	31.0%
-Përdorimi i burimeve alternative të financimit	6.0%	7.1%	7.1%	-5.7%	-5.7%	-5.3%
-Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë	9.1%	10.6%	5.6%	0.0%	0.0%	1.4%
-Kushtet e kreditimit të aplikuara nga banka juaj	32.4%	25.3%	22.6%	25.7%	31.5%	17.0%
-Situata aktuale ose e pritshme makroekonomike	-21.9%	1.4%	13.2%	1.8%	1.8%	-4.0%

Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Aneksi 2. Kredia për individë

Rezultatet e pyetësorit analizohen duke llogaritur balancën neto si diferencën e përgjigjeve të peshuara të bankave, që kanë raportuar lehtësim/rritje të standardeve/kërkesës dhe atyre, që kanë raportuar shtrëngim/ulje të standardeve/kërkesës. Në procesin e agregimit të rezultateve, përgjigja e secilës bankë peshohet si në bazë të përgjigjes së saj ashtu edhe në bazë të peshës së madhësisë së bankës. Për shembull, bankave që janë përgjigjur se standardet janë “shtrënguar shumë” u është dhënë dyfishi i peshës, krahasuar me përgjigjet “shtrënguar pak”. Peshat e madhësisë ndërtohen duke u bazuar në pjesën që secila bankë zë në tregun e kredisë dhe rishikohen një herë në vit. Balancat neto janë shkallëzuar në mënyrë që të marrin vlera brenda intervalit +/- 100.

INDIVIDE	T2'16	T3'16	T4'16	T1'17	T2'17	T3'17
Si kanë ndryshuar standardet e miratimit të kredisë?						
- Tremujorin e kaluar	10.1%	18.4%	13.2%	18.3%	10.6%	5.9%
- Tremujorin e ardhshëm	6.0%	3.8%	4.9%	5.0%	-2.3%	0.0%
Faktorët që kanë ndikuar standardet e miratimit të kredisë:						
-Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës	10.1%	11.3%	11.3%	11.7%	16.6%	7.8%
-Vendimet e Bankës së Shqipërisë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
-Konkurrenca e sistemit bankar	16.1%	18.9%	23.8%	17.6%	17.6%	3.7%
-Niveli aktual ose i pritshëm i likuiditetit	10.1%	15.6%	10.1%	11.7%	11.7%	11.7%
-Gjendja financiare e individëve	-6.3%	-6.3%	-10.1%	-12.9%	-12.9%	-14.0%
-Kreditë me probleme	-15.7%	-15.7%	-15.7%	-10.6%	-10.6%	-5.6%
-Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme	-11.3%	-8.9%	-5.1%	-12.9%	-12.9%	-10.6%
Si kanë ndryshuar kushtet e miratimit të kredisë?						
-Marzhi mesatar	24.9%	24.0%	17.9%	22.8%	16.6%	16.6%
-Marzhi për kreditë me rrezik	-1.2%	5.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
-Komisionet	1.6%	4.0%	5.0%	3.9%	3.9%	3.9%
-Madhësia e kredisë	-1.2%	1.2%	2.2%	0.0%	5.0%	3.3%
-Kërkesa për kolateral/në raport me madhësinë e kredisë	-0.2%	2.8%	2.8%	2.8%	1.7%	12.8%
-Maturiteti maksimal i kredisë	-1.2%	1.2%	1.2%	-1.1%	0.0%	3.3%
-Raporti këst/të ardhura	-1.2%	4.0%	4.0%	5.5%	7.7%	3.9%
Si ka ndryshuar kërkesa e individëve për kredi?						
-Kredi për shtëpi	11.4%	2.2%	2.5%	-4.9%	0.0%	14.2%
-Kredi për konsum	27.6%	37.0%	36.3%	30.2%	52.7%	0.2%
Faktorët që kanë ndikuar ndryshimin e kërkesës për kredi:						
-Nevoja e individëve për financimin e blerjes së shtëpisë	17.5%	23.3%	12.7%	5.3%	15.1%	24.6%
-Nevoja e individëve për financimin e konsumit	27.6%	27.4%	20.7%	17.4%	27.3%	24.6%
-Përdorimi i burimeve alternative të financimit	8.6%	5.4%	-16.8%	-20.2%	-15.4%	3.4%
-Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë	16.4%	4.9%	0.0%	-1.1%	-1.1%	2.3%
-Besimi i konsumatorëve	1.2%	-13.8%	-8.9%	-8.4%	-9.5%	2.7%
-Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme	9.3%	-7.2%	3.2%	-7.8%	-2.9%	-5.5%
-Kushtet e kreditimit të aplikuara nga banka juaj	30.5%	27.2%	16.4%	20.3%	32.9%	11.8%

Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.